VËSHTRIM I TOGFJALËSHAVE DHE ANTONIMEVE NË KANUNIN E LEKË DUKAGJINIT

OVERVIEW OF PHRASES AND ANTONYMS IN THE KANUN OF LEKË DUKAGJINI

Gani S.PLLANA
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike Prishtinë
gani.pllana@uni-pr.edu; ganipllana44@gmail.com

Përmbledhje

Në këtë punim vështrohen disa çështje të karakterit të përgjithshëm të togfjalëshave të qëndrueshëm dhe të antonimeve në Kanunin e Lekë Dukagjinit, si edhe shtrohen probleme teoriko-praktike, të cilat mund të thellohen në studimet e mëtejme.
Togfjalëshat e qëndrueshëm duke shënuar nëpërmjet lidhjeve të qëndrueshme të gjymtyrëve të tyre objekte ose dukuri të veçanta të konceptuara si të tilla të realitetit, paraqiten si një mjet i efektshëm me një lehtësi të madhe formimi për plotësimin e nevojave të terminologjisë.
Në këtë punim do të bëjmë analizën e antonimeve në materialin e botuar të Kanunit të Lekë Dukagjinit, së pari si fjalë që duhen shpjeguar dhe së dyti, si fjalë që ndihmojnë për të shpjeguar. Gjatë vështrimit të antonimeve jemi nisur nga parimi që kuptimi i një fjale (fjalie) të del sa më i qartë, duke praktikuar shpjegimin e kuptimit të fjalës antonim (fjalisë antonime) me anë të mohimit të kuptimit të antonimit të saj.

Fjalë çelës: Kanuni i Lekë Dukagjinit, togfjalëshat e qëndrueshëm, antonimet.

Abstract

This paper examines various general aspects of stable phrases and antonyms in the Kanun of Lekë Dukagjini, as well as theoretical and practical issues that could be explored in future studies.
Stable phrases, which represent fixed connections between parts of speech referring to specific objects or phenomena conceived as such in reality, serve as an effective tool for terminology, offering ease of formation to meet linguistic needs.
In this paper, we analyze antonyms found in the published version of the Kanun of Lekë Dukagjini—firstly as terms that require clarification, and secondly as tools that aid in clarification. In our analysis, we begin with the principle that the meaning of a word (or sentence) should be as clear as possible. To achieve this, we apply the method of explaining a word's meaning by negating its antonym.

Keywords: Kanun of Lekë Dukagjini, stable phrases, antonyms**.**

Hyrje

Kanuni i Lekë Dukagjinit është një përmbledhje e zakoneve dhe rregullave tradicionale të së drejtës zakonore shqiptare, që është transmetuar gojarisht për shekuj me radhë. Ai nuk është shkruar nga vetë Lekë Dukagjini, por është emërtuar sipas tij, sepse mendohet se ai ka ndikuar në kodifikimin ose përdorimin e tij në zonën e veriut të Shqipërisë. Lekë Dukagjini ka lindur rreth vitit 1410 dhe mka vdekur në vitin 1481, princ shqiptar, bashkëkohanik i Skënderbeut. Për herë të parë, Kanuni është mbledhur dhe shkruar në formë të plotë nga Shtjefën Gjeçovi në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Ai ishte prift dhe studiues shqiptar, dhe arriti të përpilojë versionin më të njohur të Kanunit, i cili u botua pas vdekjes së tij në vitin 1933.
Kanuni i Lekë Dukagjinit, i mbledhur dhe përpunuar nga Shtjefën Gjeçovi, është botuar për herë të parë në Shkodër, në vitin 1933, pas vdekjes së tij. Botimi u bë nga *Instituti Françeskan i Shkodrës*, një institucion i rëndësishëm kulturor dhe fetar që kishte edhe shtypshkronjën e vet, ku janë botuar shumë vepra me rëndësi për gjuhën dhe kulturën shqiptare.

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp122

Leksiku terminologjik

Leksiku terminologjik përfshin fjalët që përdoren vetëm në një fushë të caktuar të artit, të jetës shoqërore, të shkenës, të teknikës etj. Termat (lat. terminus "kufi, shenjë kufitare") janë fjalë të veçanta, që kanë kuptime speciale. Për shkak të rolit të madh që luajnë në jetën e përditshme, studimi i leksikut termminologjik të fushave të ndryshme të dijes, si sistem elementesh të lidhura e të ndërvarura në përputhje me sistemin ne koncepteve të fushave përkatëse, ka një rëndësi të veçantë.
Terminologjia ka si objekt zbulimin e veçorive të termave, pasurimin, përpunimin dhe sistemimin e leksikut terminologjik për ta bërë të aftë të shprehë sa më qartë e më sktë konceptet shkencore në fusha të ndryshme të jetës shoqërore. Njëkuptimësia është një kusht themelor për funksionimin e një termi ideal dhe kjo bën që përmbajtja e termave të merret vesh lehtë edhe jashtë kontekstit. Në sistemet terminologjike, më shumë se në shtresa të tjera të leksikut, duket ndërhyrja e vetëdijshme për zgjedhjen, përpunimin dhe sistemimin e tyre.
Për krijimin e termave shfrytëzohen rrugë e burime të ndryshme. Pjesa më e madhe e termave në një gjuhë vjen nga fjalë të leksikut të përgjithshëm që janë specializuar në një fushë të caktuar të dijes.
Fjalët e zakonshme, përveç konceptit, shprehin shpesh edhe ngjyrime ndjenjësore, stilististike etj., dmth. ato jo vetëm emërtojnë, por tregojnë edhe qëndrime emocionore ndaj dukurive që shënojnë.
Fjalët veç e veç nuk mund t'u shërbejnë njerëzve për t'u marrë vesh ndërmjet tyre. Ato kanë vetinë që të lidhen njëra nme tjetrën sipas ligjeve të gjuhës, sipas rregullave të gramatikës dhe ashtu së bashku formojnë njësi gjuhësore më të larta, togfjalësha në fjali, të cilat përdoren gjatë ligjërimit.

Togfjalëshat në Kanunin e Lekë Dukagjinit

Togfjalëshi jep një informacion të ngushtë, por të thellë, p.sh. *Prift i katundit*, nuk është barazi me *famullitar*. Kurse fjala jep një informacion të gjërë, por të cekët, p.sh. *Prift* më i gjerë sesa *famullitar.* Kjo bën që ashtu si fjalë të veçanta mund të katagolizohen (të mblidhen e të klasifikohen, duke i paraqitur si të përbashkëta deri tek një fjalor, ashtu edhe togfjalëshat, kryesisht të qëndrueshëm: *hije e Kishës; oborr i Kishës* mund të katagoligjohen deri në hartimin e një fjalorthi i cili jep një informacion të konsideruar që në tekst jepet i shpërndarë. Kjo na ka bërë që të paraqesim disa togfjalësha të qëndrueshëm (gjysmëqëndrueshëm) i nxjerrë nga përbërja leksikore togfjalëshore e veprës (10 faqet e para) (emër + emër): *hija e Kishës, i Pari i fesë, djemtë e Bajrakut (Flamurit), bana (qela) e famullitarit, tagri (tagari) i Kishës, paperlimsija e Kishës, pari i fesë (fes), ndera e Kishës, Flamurit (Bajrakut), pronat e Kishës, pasunitë e Kishës, Meshtarit të Kishës, gjanë e Kishës, rregullimi i pasunis së kishës, Meshtari i Famullis, tagari e detyrës e Famullitarit, Kanunit të vendit, gjave të gjalla, vehtja e Famullitarit, shpija e Meshtarit, gjygjit të Kanunit, rriogtari i Kishës, punteria e Kishës, punëtorët e Kishës, gjoba (gioba) me pare, dorasi i katundit, sundimi i shpis, armët e krahut, zot't të shpisë, tagri i shpis, zoja e shpis, fitimeve të shpis, tagër ylku, tagër bariu etj.*
Këta togfjalësha janë më të njohur, sepse ajo që shprehet prej tyre, ndeshet shpesh në vepër, kanë rëndësi në jetën e përditshme.
Fjalët të cilat përbëjnë informacionin themelor, në vepër, kanë edhe një përsëritshmëri (shpeshtësi) në vepër.

1. Përsëritshmëria: *Kishë (kishës) 138 raste*
Famulli 61 raste
Shpi (shpisë) 80 raste
Famulltari (Famullitari) 66 raste
Tagër (tagri) 144 raste
Flamurit (i Bajrakut) 123 raste
Gjobë (giobë) 110 raste
Gja (gjanë) 80 raste
Kanun 126 raste

2. Nga ana kuptimore; lidhjet sinonimike (njëri jepet në kllapa); *Flamur (Bajrak), bana (qela), oborr (vend) i Kishës* etj.
3. ***Nga ana tematike:*** p.sh. *Kishë, vend, oborr, shtëpi (ship).*
4. Përmbajtja: *pronë, barrë.*
5. Emër personi: *prift, famullitar, i Pari i Kishës.*



Në organizimin sistemor të terminiologjisë ndihmojnë edhe pozicionet antonimike. Antonimia karakterizon pozitivisht terminologjinë pikërisht se dëshmon lidhje sistemore të koncepteve, për një terminologji të zhvilluar në sistem.

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit, gjuha që përdoret për të përshkruar rolin e gruas shpesh pasqyron një rend shoqëror patriarkal, ku gruaja ka një pozitë të nënshtruar në raport me burrin, familjen dhe shoqërinë.

Në vazhdim po paraqesim disa antonime nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, për të ilustruar këtë, do të prezantoj disa terma dhe antonime të mundshme që shfaqen në Kanun në lidhje me gruan:

1. ***Gruaja si "rob i burrit"***
   - Në Kanun: *"Gruaja asht si shpija: nuk flet pa leje, nuk del pa leje".*
   - ***Antonimi*** i kësaj ideje do të ishte: *"Gruaja si e lirë, e pavarur,"* që është jashtë përfytyrimit të Kanunit.
2. ***Gruaja si objekt trashëgimie / pasuri***
   - Në Kanun: Në rastin e martesave të paracaktuara apo kur vritet burri, gruaja mund të *"mbetet për shpi"* ose t'i jepet dikujt tjetër.

- ***Antonimi:*** *Gruaja si subjekt me të drejtë për zgjedhje martesore.*

3. ***Gruaja dhe gjakmarrja***
   - Në Kanun, gratë përjashtohen nga gjakmarrja direkte, por jo nga pasojat e saj.
   - ***Antonimi*** do të ishte:*"Përfshirja e gruas si palë e barabartë në drejtësi ose mbrojtje ligjore".*
4. ***Gruaja si e nënshtruar***
   - Kanuni thotë: *"Gruaja s'ka za në kuvend".*
   - ***Antonimi:*** *"Gruaja ka të drejtë fjale e vendimmarrjeje."*
5. **Gruaja si nënë (e nderuar), por jo si individ**
   - Në shumë raste, gruaja fiton respekt vetëm si nënë e djemve ose si *"gruaja e burrit të ndershëm".*
   - ***Antonimi:*** *"Gruaja vlerësohet për vlerat dhe arritjet e saj personale".*
6. **Përgjegjësia e burrit për gruan dhe familjen**
   - **Në Kanun**: *"Burri është kreu i shpisë dhe gruan nuk e pyet asnjëherë".*
   - ***Antonimi:*** *"Gruaja ka të drejtë të vendosë për vetveten dhe familjen."*
     (Ky do të ishte një mundësi që tregon një shoqëri ku gratë kanë të drejta të plota për vendimmarrje dhe janë të barabarta me burrat.)
7. **Gratë dhe gjakmarrja**
   - **Në Kanun**: *"Gjakmarrja nuk i përket gruas."*
   - ***Antonimi:*** *"Gruaja ka të drejtë të kërkojë hakmarrje për nderin e saj".*
     (Ky do të përfaqësonte një shoqëri ku gratë janë të barabarta dhe mund të kërkojnë drejtësi për veten e tyre, përfshirë në raste hakmarrjeje.)
8. **Gratë dhe marrdhëniet shoqërore**
   - **Në Kanun**: *"Gruaja nuk flet në kuvend, as nuk merr pjesë në vendimmarrje."*
   - ***Antonimi:*** *"Gruaja ka të drejtë të marrë pjesë në kuvende dhe të kontribuojë në vendimmarrje."*
     (Kjo pasqyron një shoqëri ku gratë kanë mundësi të barabarta në të gjitha fushat, përfshirë politikën dhe shoqërinë.)
9. **Përgjegjësia dhe nderi i gruas**
   - **Në Kanun**: *"Nderi i gruas është nderi i burrit."*
   - ***Antonimi:*** *"Gruaja ka nderin e vet dhe është e barabartë me burrin në ruajtjen e dinjitetit dhe nderit."*
     (Ky antonim do të pasqyronte një shoqëri ku gratë kanë autonomi dhe dinjitet të pavarur, pa u varur nga burrat).
10. **Martesat dhe të drejtat e gruas**
    - **Në Kanun**: "Gruaja është e martuar me dëshirën e babait, jo me dëshirën e saj."
    - **Antonimi:** *"Gruaja ka të drejtë të zgjedhë bashkëshortin e saj, pa ndërhyrje të tjerëve".* (Ky antonim paraqet një shoqëri ku gratë kanë lirinë dhe të drejtat e plota për të zgjedhur partnerët e tyre).

Këto janë disa nga shprehjet që përshkruajnë një kontrast të theksuar mes normave patriarkale të kohës dhe mundësisë për të pasur një shoqëri më të barabartë. ***Kanuni*** pasqyron një sistem të ngurtë dhe tradicional, dhe këto antonime sugjerojnë një shoqëri më të hapur dhe të drejtë për gratë.

Përfundim

Kanuni i Lekë Dukagjinit është një vepër që lidhet me ligjet e pashkruara, por meqë ka të bëj me ligjet, andaj është e afërt me ligjet e shkruara (siç është e drejta, legjislacioni).

Kjo vepër është dukuri special, system i rregullave që organizojnë shoqërinë, merr vlerë të veçantë edhe në formë të pashkruar dhe të shkruar siç është sot ligjshmëria (legjislacioni).

Nga pikëpamja e koncipimit të përmbajtjes kjo delë e kjartë nga vetë emërtimi ***Kanun*** (tërësi e rregullash që duhen zbatuar në shoqëri), por të pashkruara në atë kohë.

Kanuni i Lekë Dukagjinit do të thotë ligjshmëria e pashkruar e krijuar nga Lekë Dukagjini, bashkëkohës i Skënderbeut (shek. XIV) dhe e hedhur në letër nga Shtjefën Gjeqovi (shek. XX). Lekë Dukagjini ishte ligjbërësi, por në formë të pashkruar.

Nga pikëpamja e ligjit të sotëm, janë ligje (por të shkruara), të cilat kanë kaluar nga goja në gojë nëpër shekuj.

Merita e Shtjefën Gjeqovit ishte gjithashtu që pas 4-5 shekujsh i ka mbledhur me të dëgjuar dhe i ka hedhur në letër, të cilën e kemi marrë në studim.

Si vepër kapitale jep mundësinë që të vështrohet, siç është trajtuar realisht; nga ana e historisë, nga ana e përmbajtjes, por mund të bëhet edhe nga ana gjuhësore (emërtimet) në funksion të informacionit që jep teksti i shkruar.

Referencat

[1]. Duro, Agron: *"Terminologjia si system",* PANTEON, Tiranë, 2001.

[2]. Duro, Agron : *"Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme",* në STUDIME MBI LEKSIKUN DHE MBI FORMIMIN NE FJALËVE NË GJUHËN SHQIPE III, USHT IGJL SLLTiranë, 1989, f [p]. 665-630.

[3]. Gjeqovi, Shtjefën: *"Kanuni i Lekë Dukagjinit",* ARTINI, Prishtinë, 2022.

[4]. Lafe, Emil: *"Leksiku terminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar",* në 'Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe, problem e detyra", ASHSH dhe ASHAK, më 19 qershor 2009, Tiranë, 2009.

[5]. Pasho, Hëna: *"Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe"*, ASA IGJL, BOTIMET ALBANOLOGJIKE, Tiranë, 2017.

[6]. Pllana, Gani; Duro, Agron: *"Kontribut i veçantë i akademikut Jani Thomai për terminologjinë shqipe",* ALBANOLOGJIA 11 (2020), Prishtinë, 2021.

[7]. Pllana, Gani: *"Formimi i terminologjive teknike shqipe mbi bazën e leksikut të përgjithshëm (Procese të krijimit, të pasqyrimit në gjuhë dhe të standardizimit"*, QSA IGJL, Tiranë, 2017.

[8]. Samara, M.: *"Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe"*, ASHSH IGJL, Tiranë, 1985.

[9]. Samara, M.: *"Mbi antonimet në togfjalësha dhe mbi antoniminë e togfjalëshave të qëndrueshëm në gjuhën shqipe"*, në STUDIME MBI LEKSIKUN DHE MBI FORMIMIN NE FJALËVE NË GJUHËN SHQIPE I, USHT IGJL SLLTiranë, 1972, , f [p]. 247-256.

[10]. Thomai, Jani: *"Leksikologjia e gjuhës shqipe",* QTAL, Tiranë, 2020.